



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 1-rë inauguruese të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 26.11. 2021 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, anëtar
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Elmaze Behluli, anëtare
4. Shefki Bytyqi, anëtar
5. Gazmend Qerkini, anëtar
6. Shkelzim Olluri, anëtar
7. Albiona Tasholli, anëtar
8. Fadil Sopa, anëtar
9. Safete Amerllahu, anëtare
10. Hyra Bytyqi, anëtar
11. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
12. Sami Bytyqi, anëtar
13. Fitim Shala, anëtar
14. Xhyzide Rustemi, anëtare
15. Rinor Murati, anëtar
16. Armend Grajqevci, anëtar
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtar
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar

28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Syla, anëtare
30. Lulzim Qerimi, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Zenel Tasholli, kryetar i Gjykatës Themelore në Lipjan
3. Naser Sinani, Komandati i Stacionit Policor në Lipjan
4. Zaim Baftiu, Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan
5. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
6. Drejtorët e drejtorateve nga mandati i kaluar
7. Përfaqësues të OSBE-së
8. Përfaqësues të OJQ-ve
9. Përfaqësues të medieve dhe
10. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Mbledhjen e kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit Sami Bytyçi i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe në vazhdim kërkoi nga Sektori i Kuvendit që të thirrë me emër anëtarët e Kuvendit dhe pas thirrjes me emër të anëtarëve u konstatua se në mbledhje prezentojnë të gjithë anëtarët e zgjedhur gjithsej 31 dhe se mund të vazhdohet me punë.

Pastaj Kryesuesi tha se për këtë mbledhje është paraparë ky:

REND DITE

1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
2. Dhenia e betimit të Kryetarit të Komunës
3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
4. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Sami Bytyqi, ftoi anëtarët e zgjedhur të Kuvendit që të ngritën në këmbë dhe të bëjnë betimin duke lexuar deklaratën solemne.
Pastaj anëtarët e Kuvendit duke lexuar deklaratën solemne dhan betimin.

Shtesë: Deklaratat solemne.

II

Dhënja e betimit të Kryetarit të Komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Sami Bytyqi, ftoi Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmetin për dhënien e betimit dhe një fjalë përshëndetëse para anëtarëve të kuvendit.

Në vazhdim Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti dha betimin para anëtarëve të Kuvendit duke lexuar deklaratën.

Shtesë: Deklarata solemne.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Sami Bytyqi ftoi Kryetarin e Komunës Imri Ahmeti që të marrë fjalën.

Imri Ahmeti, kryetari i Komunës, së pari i uroj Kryesuesit të mbledhjes për menaxhimin e mbledhjes, pastaj i përshëndes të gjithë të pranishmit në sallë, dua ti falënderoj edhe oponentët politike. Po ashtu ju uroj shëndet dhe punë të mbarë të gjithë asamblesitëve. I falënderoj të gjithë qytetarët e komunës së Lipjanit për mbështetjen e vazhdueshme. Unë për të 3 tën herë po filloj detyrën e punës, e ju qytetarë me keni bërë krenarë dhe më obligoni më shumë që të punojmë me fort dhe me përgjegjësi që ta zhvillojmë komunën tonë. Unë bashkë me ekzekutivin do ta shtojmë ritmin e punës për të mirën e qytetit tonë dhe fshatrave tona. E falënderoj ekipin e deritashëm të ekzekutivit për punën që kanë bërë. Shume shpejt do ta caktoj edhe ekzekutivin e ri dhe drejtoret do të emërohen vetëm për një vit kalendarik. Sepse do ta rishikojmë punën disiplinën dhe rezultatet e tyre, vlerësimin do ta bëjmë së bashku me qytetarët duke marrë sugjerimet vërejtjet. Dhe askush nga ekzekutivi nuk do të lejohet të ndeshet me ligjin. Në seancat e ardhshme do të paraqesim në kuvend edhe strukturën e administratës, dhe do të bashkëpunojmë me të gjithë për të mirën e qytetarëve të komunës tonë!

Pastaj u kalua në pikën tjetër të rendit të ditës

III

Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Sami Bytyqi, njoftoi Kuvendin se për zgjedhjen e Kryesuesit janë të parapara disa procedura: të zgjidhen dy komisione me nga 3 anëtarë dhe atë:

1. Formimi i komisionit zgjedhor dhe
2. Formimi i komisionit verifikues.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes pyeti anëtarët se a ka propozime për anëtarë të komisionit zgjedhor.

Hyra Bytyçi e propozoi Fitim Shalën.

Lulzim Rustemi e propozoi Lumturie Bytyqi-Hasani,

Alban Salihu e propozoi Fadil Sopen ,

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Sami Bytyçi vuri në votim propozimet për anëtarët e komisionit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 31 vota për aprovoi propozimet për anëtarët e komisionit zgjedhor

Për komisionin verifikues u propozuan si vijon:

Hyra Bytyçi propozoi Albiona Tashollin,

Lulzim Rustemi propozoi Herolind Kozhanin,

Alban Salihu propozoi Shahadije Bikliqi,

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Sami Bytyçi vuri në votim propozimet për anëtarët e komisionit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 31 vota për aprovoi propozimet për anëtarët e komisionit verifikues.

Kryesuesi i mbledhjes Sami Bytyçi ftoi Komisionit Verifikues që të verifikoj mandatin e anëtarëve.

Më pas njëri nga anëtarët e Komisionit Albiona Tasholli e njoftoi Kryesuesin e mbledhjes se nga ana e komisionit janë verifikuar mandatet ne bazë te deklaratave për betim të anëtarëve të kuvendnit të cilat janë gjithsej 31.

Në vazhdim Kryesuesi i Mbledhjes, Sami Bytyçi pyeti anëtarët e Kuvendit se a ka propozime për Kryesues të Kuvendit ?

Hyra Bytyçi,se pari i uroj mandatin Kryetarit Imri Ahmeti, punë të mbarë dhe suksese,po ashtu edhe anëtarëve të kuvendit ju uroj suksese. Kam nderin në emër të GP të LDK-së propozoi Daut Azemin për kryesues duke u bazuar në performancën e tij të treguar gjatë mandatit të kaluar

Lulzim Rustemi, ne si GP i PDK-së nuk kemi propozime për kryesues të kuvendit,por shprehim qëndrimin tonë se ish kryesuesi Daut Azemi, ka disa shkelje ligjore,dhe nuk do te duhet te jetë propozimi i duhur dhe do te jemi kundër për shkak të 3 arsyeve, kryesuesi asnjëherë asnjë petition te qytetarëve nuk e ka prurë në Kuvend,kryesuesi i kuvendit nuk e ka thirr mbledhjen e jashtëzakonshme te thirrura nga partitë opozitare, PDK dhe partitë tjera ose e ka imprivizu mbledhjen e jashtëzakonshme vetëm me drejtoreshën e arsimit dhe shpesh herë kryesuesi nuk ka qenë në gjendje me drejtu mbledhjen e kuvendit.

Me që propozime tjera nuk pati për Kryesues të Kuvendit, Sami Bytyçi kryesuesi i mbledhjes ftoi Komisionit Zgjedhor që të përgatitin listën për votim për Kryesues të Kuvendit.

Komisioni pas përgatitjes se fletëvotimeve, kutisë për votim dhe kabinës për votim, se bashku me Sektorin e Kuvendit treguan se janë bërë të gjitha përgatitjet dhe mund të fillojnë me procedurat e votimit.

Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare e komisionit i njoftoi anëtarët e Kuvendit se votimi do të bëhet duke rrumbullakuar opsionet , a-për apo, b- kundër.

Fitim Shala ftoi me emër anëtarët e Kuvendit për votim sipas listës së Sektorit të Kuvendit .

Pas përfundimit të votimit Kryetari i komisionit Fitim Shala, konstatoi se kanë votuar 31 anëtarë, dhe prej tyre me 18 vota për, 13 vota kundër Kuvendi zgjedhi Daut Azemin Kryesues të Kuvendit.

Pastaj Kryesuesi i mbledhjes Sami Bytyçi ftoi kryesuesin e posa zgjedhur të Kuvendit Daut Azemi për ta udhëhequr mbledhjen të cilit në vazhdim i uroi shëndet dhe punë të mbarë.

Daut Azemi, Kryesuesi i Kuvendit fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë duke ju uruar suksese kryetarit të komunës z.Imri Ahmeti, dhe të po sa zgjedhurve. Një falënderim i veçantë shkon për kryetarin e Komunës Imri Ahmetin, grupin e LDK-s dhe strukturat e LDK-s të gjitha strukturat LDK-së. Po ashtu i falënderoj edhe ata që me votuan dhe ata që nuk me votuan pas që demokracia e ka kështu. Unë ju zotohem se do ta kryej detyrën time pa bërë dallime në mënyrë të barabartë për secilin anëtar të Kuvendit. Një falënderim shkon edhe për qytetarët e komunës së Lipjanit të cilët më përkrahën.

IV

Fjala përshëndetëse e Kryetarit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi ftoi Kryetarin e Komunës Imri Ahmeti që të marrë fjalën.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës, tha së pari i uroj kryesuesit Daut Azemi për detyrën duke i uruar shëndet dhe suksese në punë. Po ashtu dua të falënderoj të gjithë delegatët e deritanishëm të Kuvendit për angazhimin që kanë pas. Për fund ju uroj festat e fund vitit të gjithëve.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi

Zyrtari Ligjor
Behar Aliu

Anëtar i vjetër i Kuvendit
Sami Bytyqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi